

Numri i lëndës: 2022:088465

Datë: 15.01.2024

Numri i dokumentit: 05192140

P.nr.355/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V., Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurit M.A.me vendbanim në V., rruga "A.J.", për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhërit ndëshkimor me numër PP.II.nr.631/2022, të datës 26.04.2022, pas konstatimit të dhënave në aktakuzë, të cilat ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor, me datë 15.01.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.631/2022, e datës 26.04.2022 dhe gjykata, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri M.A.me vendbanim në V., rruga "A.J.", nga babai K., i lindur me datë 20.01.1974, me numër personal 1013337370, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës:

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 01.02.2022, në shtëpinë e tij në V., në rrugën "A.J.", pas vërtetimit të gjendjes faktike të njehsorit elektrik nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it, është konstatuar se i pandehuri Muzafer Alimi, si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetes ti sjell pasuri të kundërligjshme, ka bërë vjedhjen e energjisë elektrike, ashtu që ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik dhe në këtë mënyrë ka bërë hargjimin e pa autorizuar të energjisë elektrike me qka ka pamundësuar regjistrimin e shpenzuar të energjisë elektrike, duke e dëmtuar të dëmtuarën KEDS-Distrikti në Gjilan, në vlere prej 56.88 euro.

-me këtë veprim ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 6, lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38, 81, 82 të KPK-së dhe nenit 450, 458, 495 par. 1, 498 të KPPRK-së, të pandehurit:

I SHQIPTON VËREJTJE GJYQËSORE

Ashtu që të pandehurit Muzafer Alimi, i bëhet me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprë penale dhe nëse ai sërish kryen veprë të tillë gjykata do t'i shqiptojë një sanksion më të rëndë penal.

E dëmtuara KEDS, Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallit gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) € si dhe shumën prej 20 (njëzet) € për kompensimin e viktimave të krimit, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 28.04.2022, në Gjykatën Themelore Gjilan, Dega e gjykatës në V., ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr.631/2022, të datës 26.04.2022, ndaj të pandehurit M.A.me vendbanim në V., rruga "A.J.", për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Me datë 28.04.2022 është paraqitë kërkesa PP.II.nr.631/2022, e datës 26.04.2022, për dhënien e urdhërit ndëshkimit me shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par. 2 lidhur me par. 1 të KPPRK-së.

Me parashtresën P.nr. 355/2022, të datës 24.03.2023, gjykata ka kërkuar nga prokurori i shtetit që të bëjë plotësimin e aktakuzës sa i përket vendit të saktë të kryerjes së veprës penale.

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, prokurori i çështjes me parashtresën PP.II.nr.631/2022, të datës 26.05.2023, ka bërë përmirësimin e dispozitivit të aktakuzës dhe atë si vend të kryerjes së veprës penale duhet të jetë në shtëpinë e tij në V., rruga "A.J."

Gjykata pas leximit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimit, gjeti se në këtë çështje penalo juridike, janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPPRK-së për dhënien e urdhërit ndëshkimit dhe bazuar në nenin 495 par. 1, 2 dhe 3 të KPPRK-së, vendosi që të pranojë kërkesën e lartë cekur ashtu që të pandehurit t'i shqiptojë vërejtje gjyqësore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkëngjitura në të, ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe deri tek një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë: Procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike në terren me numër 2019192, i datës 01.02.2022, fotografi mbi mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe pro fatura mbi dëmin e shkaktuar DGLHP2211574, e datës 02.02.2022, si dhe dokumentacioni tjetër përcjellës, gjeti se këto janë prova të besueshme dhe të mjaftueshme mbi bazën e të cilave konstatohet bindshëm se i pandehuri ka kryer veprë penale e cila i vihet në barrë me aktin akuzues.

Andaj, bazuar në të lartë cekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, ashtu siç është propozuar në kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimit mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, duke e udhëzuar palën e dëmtuar në kontest civil, pasi që nga të mbledhurat në këtë procedurë nuk kemi bazë të sigurt për gjykim të plotë apo të pjesërishtë të dëmit të shkaktuar në këtë çështje penale.

Vendimin sa i përket shpenzimeve procedurale, gjykata e mori duke u mbështetur në nenin 450 par. 1 të KPP-së.

Nga të lartë cekurat dhe mbështetur në nenin 495 par. 1, 2 dhe 3, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.355/2022, Me datë 15.01.2024

Gjyqtarja,
Blerina Jakupi Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, gjyqtares individuale të kësaj gjykate. Kundërshtimi nuk duhet domosdo të arsyetohet. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhërin ndëshkimor merr formën e prerë dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.